



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-9250 /2026

Datë: 01.04 /2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja c) dhe shkronja l) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në bazë të kërkesës së Asociacionit të Komunave të Kosovës për emërimin e delegatëve nga Kuvendet Komunale, Kuvendi i Komunës së Klinës, në mbledhjen e III-të të rregullt të mbajtur më datë 27.03.2026, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e delegatëve të Kuvendit të Komunës së Klinës në Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK)

1. Miratohet kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës, përkatësisht kërkesa e adresuar nga zyra qendrore e AKK-së, e cila parasheh emërimin e delegatëve nga Kuvendet Komunale të të gjitha komunave të Kosovës për të marrë pjesë dhe për të përfaqësuar interesat e komunave në punimet dhe aktivitetet e Asociacionit.
2. Kuvendi i Komunës së Klinës emëron tre (3) delegatë nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës:
 - Enver Berisha- Kryesues i Kuvendit
 - Marqe Serlmanaj – anëtare e kuvendit
 - Naim Musliu – anëtar i Kuvendit
3. Delegatët e emëruar nga Kuvendi i Komunës së Klinës janë të obliguar të veprojnë në përputhje me rregullat, statutin dhe aktet normative të Asociacionit të Komunave të Kosovës, duke përfaqësuar në mënyrë të përgjegjshme interesat e komunës.
4. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK);
- Delegatet e emëruar;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



Kryesues i Kuvendit
Enver Berisha